



SHERBIMI SOCIAL


#RRITJE E KAPACITETEVE PËR TË LEHTËSUAR MODERNIZIMIN E ASISTENCËS SOCIALE



Në kuadër të projektit për “Modernizimin e Asistencës Sociale”, në Korçë është zhvilluar një trajnim për rritjen e kapaciteteve të profesionistëve të Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror.

Trajnimi kishte në fokus hedhjen e të dhënave në sistemin e NE dhe njohuritë e marra do të përcillen në formë zinxhir tek Administratorët Shoqërorë në mënyrë që puna për modernizimin e sistemit të vijojë pa pengesa.

#REAGUJME MENJËHERË PËR TË NDIHMUAR QYTETARËT NË NEVOJË




Familja e M.SH prej pak kohësh është rikthyer në Shqipëri nga emigracioni dhe i janë drejtuar Shërbimit Social Shtetëror Shkodër për ndihmë.

Familja është orientuar për të aplikuar në skemën e Ndhmës Ekonomike, ndërkohë që vajza e çiftit po ndjek një kurs profesional dhe pas përfundimit të tij do të ndërmjetësohet për punë nga Zyra e Punës Shkodër.

Qëllimi i punës sonë në çdo rast është zgjidhja e problemeve të qytetarëve përmes ri-integrimit në tregun e punës dhe në shoqëri.



#DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK



Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK ka monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale gjatë muajit Janar, duke përpunuar të dhënat e dërguara prej tyre. Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark.

Gjithashtu në kuadër të projektit për “Modernizimin e Asistencës Sociale” është realizuar një trajnim lidhur me modulën e kontrollit dhe ankimimit me 12 drejtorët e Drejtorive Rajonale, IT dhe Drejtorinë e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK.

#DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Janar, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka kryer 33 vlerësime social-ekonomike të fëmijëve të pashoqëruar. Është vlerësuar dokumentacioni për 5 fëmijë dhe janë sistemuar në IPSH 4 prej tyre. 2 fëmijë me aftësi të kufizura janë sistemuar në institucione.

Në lidhje me të moshuarit janë shqyrtuar 17 dosje, nga të cilët janë sistemuar në institucion 9 të moshuar dhe 1 është transferuar.

Janë shqyrtuar dokumentacionet e 108 aplikantëve për Statusin e Jetimit dhe janë rinovuar 43 libreza.



#INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Puna që kryhet çdo ditë në institucionet e përkujdesit konsiderohet vërtetë e arrirë kur përfituesit e shërbimeve tona ri-integrohen në shoqëri.

Rikthimi në familjen biologjike është tregues i përpjekjeve tona për jetësimin e De-institucionalizimit. Fëmija M. L u rikthye në gjirin e familjes pas qëndrimit në Shtëpinë e Fëmijës prej vitesh.